

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-265/15**

Prishtinë,  
3 Maj 2018

Në çështjen juridike të:

**V.M.D.**

**Pala Ankuese**

Kundër;

**M. C.**

**Pala Përgjegjëse në Ankesë**

Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/262/2014, (lënda është regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA06555) të datës 21 Tetor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 3 Maj 2018, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e V. D, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/262/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës, me numrin KPA06555.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/262/2014, i datës 21 Tetor 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA06555.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datë 02 Shkurt 2007, M. S. C. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri posedimin e ngastrës kadastrale Nr.13, me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 0.04.51 ha, Komuna Kadastrale, Krstovac, Kumuna e Pejës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). E njëjta deklaron se babai i saj i ndjerë S.C. është pronar ligjor i pronës së kërkuar në të cilën ka qenë shtëpia e cila është rrënuar, nuk ka informacione se cila është gjendja e pronës ndërsa kërkon posedimin e serishëm të saj. Pala përgjegjëse në ankesë pohon se prona e paluajtshme ishte humbur si rezultat i rrethanave të vitit 1998/99 në Kosovë, duke e shënuar në formularin e kërkesës si datë të humbjes së pronës, 15.06.1999.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj ka dorëzuar në AKP provat vijuese:
  - Fletën Poseduese Nr. 11, të datës 08 dhjetor 2004, të lëshuar nga Departamenti për Kadaster dhe Gjeodezi të Republikës së Serbisë, shërbimi për Komunën e Pejës, (i dislokuar në Serbi). Bazuar në Fletën Poseduese, C. S, është pronar i pronës së kërkuar, shtëpi-ndërtesë, në sipërfaqe prej 0.00.48 ha., dhe oborr në sipërfaqe prej 0.04.03 ha, gjithsejtë në sipërfaqe prej 0.04.51 ha.
  - Certifikatën e lindjes Nr. 200-1-781së M. C., lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil e Gorazhevcit me datën 14 prill 1994,
  - Certifikatën e Vdekjes III-203-2162/2007/07, të lëshuar në Zyra e Regjistrimit Civil në Kragujevc me 29 tetor 2007, nga e cila vërtetohet se prindi i Palës Ankuese, S. C., ka vdekur me datën 12 gusht 1973 në fshatin Krstovac.
3. Më 07 Mars 2007 AKP-ja, ka bërë identifikim e pronës e cila u gjet të jetë shtëpi e shkatërruar me oborr. Me datë 24 shtator 2010, identifikimi i pronës së kërkuar ishte bërë përmes publikimit në Gazetën njoftuese të AKP-së nr. 9 dhe në Buletinin e UNHCR, në Komunën e Pejës, në Gjykatë Komunale të Pejës dhe po ashtu lista i është lënë udhëheqësit të fshatit I. S. për ti vënë në dispozicion të interesuarve. Me datë 09 shkurt 2011, nga AKP, është bërë ri-identifikimi i pronës duke e gjetur të shtëpi e re e uzurpuar nga M. D., i cili ka deklaruar se pronën e kishte blerë nga I. R. (pala e tretë) por pa e regjistruar asnjëri në emër të tyre. M. D. ndër kohë kishte vdekur.
4. Më 19 Gusht 2014 në AKP është paraqit djali i M. D.- V. D., (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), i cili e konfirmon pjesëmarrjen në procedurë para AKP-së, duke kërkuar interes ligjor. I njëjti pohon se i ati M. D. e ka blerë pronën e kërkuar nga pala e tretë para vitit 1999 i cili e kishte blerë këtë pronë prej bartësit të drejtës pronësore para 30-40 vitesh e po ashtu

- deklaron se nuk ka dokumente për të dëshmuar të drejtën pronësore për këtë pronë por do të provoj të siguroj deklaratat e dëshmitarëve.
5. Pala përgjegjëse në ankesë është kontaktuar nga Sekretaria e AKP-së por ajo e ka mohuar se prona e kërkuar i është shitur nga bartësi i të drejtës pronësore (prindi i saj) palës ankuese apo palës së tretë.
  6. Sipas raporteve të verifikimit të AKP-së, dokumentet e lartë cekura janë verifikuar pozitivisht. Gjithashtu, fleta poseduese Nr. 11e datës 26 gusht 2008 është siguruar *ex officio* nga Sekretaria dhe paraqet pronën e kërkuar në emër të babait të kërkueses si bartës i të drejtës pronësore të pronës së pretenduar.
  7. Me 21 Tetor 2014, me vendimin e vet KKPK/D/R/262/2014, KKPK-ja vendos se pala përgjegjëse në ankesë ka dëshmuar që S. D. C. është pronar i pronës së kërkuar dhe Milica Sretko Cvetković ka të drejtë në posedimin e pronës së kërkuar.
  8. Më 26 mars 2015, Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë.
  9. V. D. e ka pranuar vendimin me datën 26 janar 2015 ndërsa ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me datën 10 shkurt 2015.

#### **Pretendimet e palës ankuese**

10. V. D. thekson se nuk pajtohet me vendimin e KKPK-së i cili është në favor të palës ankuese. Sipas palës ankuese, prona është trashëgim nga të parët e tij të cilët që nga vitit 1970 kanë ardhur në këtë fshat (Krstoc) dhe se S. C. në vitin 1979 ia kishte shitur komplet tokën R. B. ndërsa gjyshi i tij, R.D. me vëllezërit e tij në vitin 1980 e kishin blerë pronën e kërkuar nga R. B.. Në pronën e kërkuar kanë qenë të ndërtuara dy shtëpi të vjetra të cilat janë djeg gjatë kohës së luftës ndërsa prej blerjes e tutje e kanë paguar tatimin në pronë por nuk kanë regjistrua të para luftës. Megjithatë ai pretendon se ka dëshmitar të shumtë (në ankesë me emër e mbiemër i cek tre dëshmitar) të cilët sipas tij janë të gatshëm të thonë realitetin para çdo organi kompetent.
11. Pala ankuese bashkëngjit dokumentet në vijim;
  - Fatura të Tatimit në Pronë të vitit 2006, të datës 19 gusht 2014 dhe 30 dhjetor 2014, në emër të M. R.D. dhe pesë foto të objekteve të banimit.

#### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesës**

12. Gjykata Supreme e Kosovës, Vendimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 ku parashihet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga njoftimi i palëve për vendimin.

#### **Meritat e ankesës**

13. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme ka vërejtur se ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk gjen prova se vendimi i ankimuar është i përfshirë me vërtetimin jo të plotë të fakteve lidhur me gjendjen faktike e as me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
14. Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999.
15. Pasi që paraqitësja e kërkesës cek se data e humbjes është Qershori i vitit 1999, kërkesa ka të bëjë me rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë.
16. Gjykata Supreme pajtohet me vendimin e AKP-së, se pala ankuese përderisa pretendon të drejtën e tij ligjore ndaj pronës nuk ka paraqitur dokumentacion apo ndonjë informacion tjetër valid në mbështetje të asaj të drejte as në kohën e identifikimit të pronës dhe as gjer në vendosje në shkallën e parë KKPK përkundër faktit se atij i është dhënë një mundësia e tillë. I njëjti për veç se është deklaruar në shkallën e parë si tani në ankesë se prona e kërkuar është blerë nga paraardhësit e tij moti kohë më parë nuk ka ofruar asnjë dëshmi që do të argumentonin një transaksion të tillë të shitblerjes nga prindi i tij apo paraardhësit e tij. Në ankesë, pala ankuese i paraqet disa fatura të tatimit në pronë por në bazë të tyre nuk mund të konkludohet fitimi i një të drejte ligjore pronësore në pronë të paluajtshme, sepse tatimi në pronë paguhet për shfrytëzimin e objekteve banesore, ndërsa nuk konfirmon titull pronësie.
17. Sipas nenit 12.11 të Ligjit 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesë nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme, përpos nëse dëshmohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Bazuar në këtë dispozitë nga pala ankuese nuk dëshmohet arsyeja e mos ofrimit të dëshmive apo pamundësia e sigurimit të këtyre dëshmive dhe të dëshmitarëve në organin e shkallës së parë, andaj si do që të jetë deklaratat e tilla tani nuk do të ishin relevante dhe nuk do të kishin efekt tjetër juridik në vendim marrje.
18. Lidhur me kërkesën e palës ankese për marrjen dhe shqyrtimin e deklaratave të dëshmitarëve të cilët do të dëshmonin eventualisht për transaksionin joformal, Gjykata Supreme ve në pah po ashtu sipas bazës ligjore si në vijim: Neni 5.3 i Shtojcës III të Urdhëresës Administrative 2007/5 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale thekson se: *“Procedura para Komisionit bazohet në parashtresat verbale dhe dokumentat, aty ku e kërkon interesi i drejtësisë, seanca verbale. Në kuptim të nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, për kërkesat vendoset mbi bazën e parashtresave nga palët, përfshirë provat dokumentuese”*. Andaj Gjykata Supreme vlerëson se lënda aktuale në shqyrtim nuk ka nevojë për sqarime shtesë, prandaj nuk është e nevojshme të zbatohet neni 12.10 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, që të mbajë shqyrtim apo të administroj prova.
19. Deklarimet eventuale të dëshmitarëve nuk do të ishin ndikim në vendimin përfundimtarë sepse të dhënat kadastrale dëshmojnë se prona është e evidentuar në emër të babait të palës

përgjegjëse në ankesë dhe bazuar në legjislacionin në fuqi konkretisht nenit 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80) e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistrat publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 pika 1, e parasheh se “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit, si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të Drejtave në Paluajtshmëri”.

20. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se konfirmimi i vendimit të KKKP-së, nuk është sjellë në dyshim nga theksimet në ankesë sepse nuk bazohen në asnjë provë të vlefshme.
21. Në bazë të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 , Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

*Beshir Islami , Kryetar i Kolegjit*

*Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it*

*Ragip Namani, Gjyqtar*

*Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it*